

## NEWSLETTER

Qershor, 2018.

Nr. 06/2018

### Procesi i aktivizimit të 5G në Republikën e Maqedonisë në fokusin e takimit të dytë publik për vitin 2018



Agjencia më 27 qershor e realizoi takimin e dytë publik për vitin 2018, në të cilin drejtori d-r Zoran Trajčevski i prezantoi aktivitetet e realizuara në pajtim me Programin vjetor të punës, gjatë tremujorit të kaluar. Ai bëri një prezantim të mbikëqyrjeve të realizuara dhe masave të shqiptuara të vërejtjes ndaj radiodifuzerëve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik, ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale si dhe botuesve të medimeve të shtypit. Në takim u arsyetua edhe angazhimi i Agjencisë për ballafaqimin me gjuhën e urrejtjes dhe nxitjes së baraxisë gjinore, si aktivitete në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në kuadër të procesit të integritimit evropian.

Theksi i veçantë ishte në procesin e aktivizimit të 5G në Republikën e Maqedonisë. m-r Igor Bojaxhiev nga Agjencia për komunikime elektronike, i cili njëherit është edhe kryetar i grupit të punës për përcaktimin e masave dhe aktivitetëve të nevojshme për aktivizimin e 5G teknologjisë mobile në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë të detajuar i arsyetoi resurset momentale infrastrukturore, rregullat në fuqi, propozim masat dhe afatet për realizimin e tyre. Në këtë grup pune që u formua nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës, merr pjesë edhe një përfaqësues nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Sipas dinamikës së përcaktuar në planin aksionar 5G të Bashkimit Evropian, deri në vitin 2020 që në së paku një qytet të madh të vendeve anëtare të Unionit duhet të sigurojnë 5G, ndërsa deri më vitin 2025 të sigurohet mbulim i plotë i të gjitha lagjeve urbane, rrugëve kryesore dhe hekurudhave.




### Deklaratë për publik

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale i dënon sulmet e djeshme ndaj punëtorëve mediatik, arrestimit të dhunshëm të gazetarëve por edhe sjelljen joprofesionale të disa gazetarëve gjatë protestës para Kuvendit të RM-së më 17 qershor. Në reagim apelohej që unëtorët mediatik duhet të jenë të liruar nga çdo formë e presionit dhe duhet t'u mundësohet që ta kryejnë punën e tyre pa pengesa, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet me interes të posaçëm publik. Në këtë kontekst, Agjencia apleon që të mos zbatohen format e komunikimit të pahijshëm me publikun, e aq më pak të nxitet çfarëdo lloj dhune, duke shtuar se vetëm me informim profesional mediatik mund të inicohen debate më të gjëra publike dhe të kontribohet për krijimin e lirshëm të mendimit publik si dhe formimit të qëndrimeve kritike.

### Mbikëqyrjet ndaj radiodifuzerëve, medimeve të shtypit dhe RRPKE

#### Radiodifuzerët

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt ndaj TV 24 Vesti, Nasha TV, TV Kanal 5 Plus dhe TV Sonce në lidhje me detyrimet për përdorimin e gjuhës në programe, detyrimet për transmetim ditor të paktën 12 orë program, përmbushjen e kuotës për programin e krijuar burimor në Republikën e Maqedonisë, impresum, informata të qasshme për përdoruesit dhe identifikimin e radiodifuzerit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se në një pjesë të programeve të Nasha TV, të emetuar më 7 maj 2018, nuk janë publikuar të dhënat për identifikimin e radiodifuzerit. Ndaj këtyre transmetuesve është realizuar edhe mbikëqyrje në lidhje me detyrimet për mbrojtjen e të miturve, rregullat për transmetimin e komunikimeve audiovizuale komerciale, detyrimet në ofrimin e kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes së shpërblyer, përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar, si dhe votimin telefonik dhe emetimin e lojërave të fatit. Me mbikëqyrjen është konstatuar se në programin e TV 24 Vesti, më 7 maj 2018, janë emetuar njoftime promovuese për program artistik pa u shënuar me sinjalizimin për mbrojtjen e personave të mitur.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE  
AUDIO DHE AUDIOVIZUELE



## NEWSLETTER

Për detyrimin që radiodifuzerët të sigurojnë të paktën 51% (MRT 1 - 60%) të programeve përgjithshme të transmetimit gjatë vitit, të jenë vepra audiovizuale evropiane dhe që të ndajë nga buxheti një minimum prej 10% për veprat audiovizuale evropiane nga prodhuesit e pavarur nga buxheti i tyre, është realizuar mbikëqyrje ndaj TV Alsat - M, TV Company 21-M, Radio Televizioni i Maqedonisë RTM 1, Nasha TV, TV Telma, TV 24 Vesti, TV Alfa, Kanal 5, Kanal 5 Plus, TV Shenja, TV Sitel dhe TV Sonce Mbikëqyrja tregoi se këto radiodifuzer kanë vepruar në pajtim me dispozitat ligjore.

Mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative në lidhje me respektimin e obligimeve nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për emetim të radios dhe televizionit, Agjencia ka realizuar ndaj Radio 5 Çoki, Radio Aleksandar Makedonski, Radio Haraçina, Radio Universitare Student FM 92.2, Lajf Radio, Radio Albana Plus, Radio Holidej, G-TV Televizija, TV Shutell dhe TV Topestrada. Mbikëqyrja tregoi se radiodifuzerët i plotësojnë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara me Rregullore.

Në bazë të një shkrese të marrë në lidhje me respektimin e parimeve nga neni 48 (ndalesa të veçanta) të LSHMAA për predikimet fetare "Nasihate të Ramazanit" të emetuar në TV Spektra nga Llabunishta, më datë 05.06.2018, Agjencia realizoi një mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore të programit të këtij radiodifuzeri. Me mbikëqyrjen u konstatua shkelje e nenit 48 nga LSHMAA, si edhe një shkelje të nenit 54 paragrafi 5 nga LSHMAA (sponsorisim i palejuar), sepse në kundërshtim me Ligjin, ky program fetar ishte i sponsorisuar. Për shkeljen është shqiptuar masa e vërejtjes.

Në bazë të parashtresës së qytetarëve, Agjencia realizoi një mbikëqyrje programore ndaj televizionit nacional TV Telma, për parimet e nenit 48 të LSHMAA, ku nuk u konstatua ndonjë shkelje.


### Mediumet e shtypit

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt administrative të 21 botuesve të medias së shkruar, me qëllim që të konstatohet nëse ata kanë publikuar impresum, të dhënat e selisë, shtypshkronjës, datës së botimit ose ribotimit dhe numrit të kopjeve të botuara, obligimi ky nga Ligji për mediume. Me mbikëqyrjen është konstatuar se të gjithë 29 mediumet e shtypit të përfshira me mbikëqyrjen e kanë plotësuar këtë obligim. Në qershor, Agjencia gjithashtu realizoi mbikëqyrje të rregullt administrative lidhur me obligimin për publikimin e të dhënave të selisë, redaksisë, shtypshkronjës, datën e e botimit dhe ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, mbikëqyrje kjo ndaj e mediave të shtypit Jeni Ballkan SHPKNJPO Shkup, botues i gazetave "Jeni Ballkan Haftalk Bilten" dhe "Jeni Balkan", ndaj Zaman SHPKNJP Shkuo, botues i gazetave "Zaman" dhe "Zaman shqip" dhe ndaj Vizioni M Shkup, botues i magazinës "Shenja". Ky obligim është plotësuar pjesërisht nga dy mediume të shtypit - gazetave javore "Jeni Ballkan Haftallëk Bilten" dhe "Zaman" të cilët nuk janë publikuar të dhënat për numrin e ekzemplarëve të botuar.

Me qëllim të konstatimit nëse botuesi i magazinës së shtypit Leona ka vepruar sipas Vendimit për masën e vërejtjes, që i është shqiptuar për mospublikim të impresumit, është realizuar edhe një mbikëqyrje kontrolluese që tregoi se ky obligim është plotësuar në tërësi. Edhe mbikëqyrja kontrolluese ndaj botuesit të magazinës Porta 3, ka treguar se në tërësi është vepruar sipas masës së vërejtjes, respektivisht në gazetë ditore është publikuar struktura pronësore, kurse prerja e publikimit është dorëzuar në Agjenci.

### RRPKE

Agjencia realizoi mbikëqyrje të rregullt programore ndaj operatorit kabllor TOTAL TV, Mobi Servis, Kabel AS KTV në lidhje me dispozitat ligjore që i referohen detyrimeve për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe për përkthim në gjuhën maqedonase ose gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë në Republikën e Maqedonisë Mbikëqyrja tregoi se Total TV në kundërshtim me dispozitat ligjore, janë ritransmetuar shërbimet programore Happy TV, Studio B, Aurora TV dhe BK TV, që nuk janë përfshirë me vërtetimet e regjistrimit të shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia. Për arsye se RRPKE Total TV paraprakisht është paralajmëruar për këtë shkelje ligjore, do të inicohet procedurë për kundërvajtje.



AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

rr. Maqedonia nr. 38, 1000 Shkup

Tel. (02) 3103400 faks: (02) 3103401

e-posta: contact@avmu.mk ueb facia: www.avmu.mk



MKC EN ISO 9001:2009